



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

**Komuna e Prishtinës**  
**Opština Priština - Municipality of Prishtina**



Në bazë të nenit 12, paragrafi 12.2, pika d, nenit 40, paragrafi 40.2, pika c të Ligjit për vetëqeverisje lokale, nr. 03/L-040, ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" nr. 28, qershor 2008, nenit 34, paragrafi 34.1, pika d të Statutit të Komunës së Prishtinës, nr. 01-110-391, të dt. 25.02.2010, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 25.11.2020 merr këtë

**V E N D I M**

**PËR SUBVENCIONIMIN E QYTETARËVE TË KOMUNËS SË PRISHTINËS TË INFEKTUAR ME COVID -19**

**I.**

**MIRATOHET** Vendimi për subvencionimin e qytetarëve të komunës së Prishtinës të infektuar me COVID -19.

**II**

Sipas pikës I të këtij vendimi, kjo pako përfshin, si në vijim:

1. Të gjithë qytetarët të cilët figurojnë në listat zyrtare të Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike (IKSHP)-së, që kanë qenë dhe që janë të infektuar me virusin COVID -19, do të subvencionohen nga Komuna e Prishtinës në shumën prej 50.00 Euro;
2. Të gjithë qytetarët mbi moshën 65 vjeç të cilët figurojnë në listat zyrtare të IKSHP-së, që kanë qenë dhe që janë të infektuar me virusin COVID -19, do të subvencionohen nga Komuna e Prishtinës në shumën prej 100.00 Euro;

**III.**

Të gjithë personat të cilët do të subvencionohen nga Komuna e Prishtinës, duhet të jenë të regjistruar në regjistrat civilë, me adresë të vendbanimit në komunën e Prishtinës.

IV.

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen Kryetari i Komunës, Drejtorja e Financave dhe drejtoritë tjera relevante.

V.

Ky vendim hyn në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

**KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS**  
01-422/01-0217897/20, më 26.11.2020

**KRYESUESI I KUVENDIT**

Agim Kuleta

